

Data 18.04.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN E REALIZIMIT TË PROCEDURËS NË NJË KONTRATË

OBJEKTI I PROCEDURËS: **“Procedurë e Hapur mbi kufirin e lartë monetar”**, me objekt:
“Blerje konteneri për përballimin e situatave emergjente”

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: **41,231,702 (dyzetë e një milion e dyqind e tridhjetë e nje mije e shtateqind e dy) lekë pa tvsh lekë pa tvsh,**

Sipas kursit zyrtar të këmbimit të Bankës së Shqipërisë kjo vlerë konvertohet në **365,270.21 Euro**

* **Kursi zyrtar i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë në datën 14.04.2023 12:37:45 është 112.88 Lekë/Euro**

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

Arsyeja kryesore e mosndarjes së procedurës së prokurimit në lote është se, referuar Specifikimeve Teknike, Autoriteti Kontraktor e ka të pamundur teknikisht ta ndajë këtë kontratë në lote të veçantë pasi e ka të vështirë ose të pamundur për të përcaktuar paraprakisht ndarjen e mallrave që do të prokurohen.

Nga ana tjetër referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 2 prashikohet shprehimisht se: **“Qëllimi i këtij ligji është:**

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, parashikohet shprehimisht:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.

2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.

Referuar Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, neni 14, Operatorët ekonomikë, parashikohet shprehimisht se:

1. Kandidatët ose ofertuesit mund të jenë persona fizikë ose juridikë.
2. Grupe operatorësh ekonomikë mund të dorëzojnë oferta ose të paraqiten si një kandidat i vetëm sipas parashikimeve në rregullat e prokurimit publik. Autoriteti ose enti kontraktor nuk duhet t'i kërkojë një formë të veçantë ligjore bashkimit të shoqërive, për qëllim të dorëzimit të

ofertës ose kërkesës për pjesëmarrje.

Autoritetet ose entet kontraktore mund t'u kërkojnë grupeve të operatorëve ekonomikë që të marrin një formë ligjore specifike, pasi të jenë shpallur fitues, nëse vlerësohet e nevojshme për realizimin e kontratës. Në çdo rast, ky kusht duhet t'u bëhet i ditur operatorëve ekonomikë në dokumentet e tenderit për ekzekutimin e kënaqshëm të kontratës.

3. Rregullat për mënyrën e plotësimit të kriterëve nga grupet e operatorëve ekonomikë në një procedurë prokurimi përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.

Në VKM Nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Kreu XI, neni 88, është parashikuar:

1. Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2. Anëtarët e bashkimit të operatorëve ekonomikë caktojnë në kontratën e bashkëpunimit ndërmjet tyre përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo kontratë bashkëpunimi duhet të dërgohet së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi. Përfaqësuesi duhet të bëjë edhe sigurimin e ofertës, duke specifikuar pjesëmarrjen në bashkimin e operatorëve ekonomikë.

3. Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76, të LPP-së, dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën "a", të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.

Referuar sa më sipër legjislacioni i prokurimit publik njih gjithashtu të drejtën e shoqërive për t'u bashkuar për të përmbushur një kontratë prokurimi, në kushtet kur kjo kontratë nuk mund të realizohet nga një operator ekonomik.

Akoma më tej, legjislacioni me ndryshimet e fundit që ka pësuar ka hequr nevojën për kontratë noteriale por vetëm paraqitjen e një kontratë bashkëpunimi ndërmjet operatorëve ekonomik, të cilët ushtrojnë aktivitetin e tyre në qarqe të ndryshme.

Mos ndarja në lote e procedurës së prokurimit, nuk e kufizon tregun, pasi kriteret e hartuara në DST janë gjithëpërfshirëse, termat e referencës janë hartuar në mënyrë të tillë që tu jepet hapësirë dhe mundësi të gjithë operatorëve ekonomikë të interesuar për tu bërë pjesë e procedurës të sipërcituar.